

2 Migrantet/ët kundër iniciativës shfuqizuese
Të votosh domethënë të bashkëvendosësh

3 Ngrohja globale dhe rinia klimatike Nevojiten politika
ristrukturimi ekologjiko-
shoqëror

4 Koronavirusi dhe të drejtat e punëmarrësve Infomacione të dobishme dhe të rëndësishme

Nr. 2 | mars 2020 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Për shkak të Koronavirusit, Qeveria Federale e Zvicrës vendosi të shtyjë votimin e 17 majit 2020. Mbi datën e re të votimit informimi do të bëhet më vonë.

Të ulen pagat, të shfuqizohen të drejtat? Jo iniciativës shfuqizuese të SVP/UDC!



Migrantet/ët të vendosur kundër iniciativës shfuqizuese, e cila sulmon të arriturat shoqërore, mbrojtjen e pagave dhe të drejtat themelore në punë dhe jetë

Ka shumë arsye, të cilat flasin kundër iniciativës së SVP/UDC. Ajo venë në pikëpyetje të drejtat e migrantëve/ëve, është diskriminuese, ngjall paragjykimet kundrejt migrantëve/ëve, nxit grupet e ndryshme kundër njëra tjetrës. Ajo do të përmbyste Zvicrën në izolim dhe do të shkaktonte kaos juridik. Por, para së gjithash sulmon të drejtat e punëmarrësve. Iniciativa refuzohet nga persona e persona me pozicione të ndryshme politike. Mirëpo, mos të mashtroni veten: Edhe iniciativa për emigrim të peshuar dukej të kishte një refuzim të ngjashëm, megjithatë ajo u aprovua. Andaj, është me rëndësi që të luftojmë deri në momentin e fundit për një shumicë dërrmuese kundër iniciativës anuluese.

Marek Wieruszewski

Unë dëgjoj shumë emërtime. Si është shënuar iniciativa në fletën e votimit?

Ajo mban emrin iniciativa popullore «për emigracionin e moderuar (iniciativa kufizuese)». Mirëpo, ne e quajmë «iniciativë shfuqizuese», pasi çka ajo në të vërtetë synon, është që të anulohet Marrëveshjen me BE-në për lëvizje të lirë të njerëzve.

Cilat do të ishin konsekuencat?

Shfuqizimi i lëvizjes së lirë të njerëzve si pasojë do të kishte automatikisht shfuqizimin e masave shoqërore mbrojtëse. Masat shoqërore mbrojtëse (FlaM/Md'a) garantojnë mbrojtjen e pagave në Zvicër përmes zgjerimit të lehtësuar të KKP, futjen e pagave minimale në degët problematike si dhe kontrollat, deponimi i depozitave, detyrimi i lajmërimit të personelit të dërguar nga BE-ja dhe gjobat në rast të shkeljeve të përsëritura. Ky sistem është

treguar si i qëndrueshëm, Iniciativa donë të shfuqizojë të gjitha këto.

A do të prekte ajo shtetasit jashtë BE-së?

Në dukje ajo ka të bëjë vetëm me shtetasit/et e BE-së. Përmes sulmit në lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mbrojtjes së pagave, iniciativa venë pyetje të drejtat e të gjithë punëmarrësve. Ajo prek të drejtat themelore të të gjithë migrantëve/ëve, pasi që ajo faktikisht do të qonte në statusin e pasigurt të qëndrimit për të gjithë. Futja e serishme e kontingjentëve për fuqinë e huaj punëtorë do t'ua plaçkiste të drejtat shumë të punësuarve. Presioni dhe konkurrenca në mesin e punëmarrësve do të rriste punën e parregullt në të zezë dhe dumpingun në paga. E gjithë struktura e pagave do të nënshtrohej një presioni.

A nuk do ta zvogëlonte iniciativa migracionin dhe në këtë mënyrë konkurrencën midis punëtorëve?

Problemet në tregun e punës nuk janë të shkaktuara nga imigracioni, porse ato janë të ndërlidhura ngushtë me gjuetinë për profit me çdo çmim: Në vitet e fundit përfitimet e aksionarëve kanë arritur lartësinë rekorde, në vitin 2019 pagesat e dividendëve të 30 ndërmarrjeve me të mëdha zvicerane ishin në lartësinë prej 41 miliarda frangash. Këto fitime shkojnë në kurriz të vendeve të punës të sigurta dhe të mira. Shfuqizimi i lëvizjes së lirë të njerëzve dhe kthimi tek kontingjentet nuk do të ulin konkurrencën në tregun e punës, përkundrazi. Përvoja nga e kaluara tregon se do të vije fuqi punëtorë edhe më e lirë, porse tani pa të drejta të njëjta.

Përse SVP/UDC ka iniciuar këtë nismë?
SVP/UDC donë tu ulë pagat e

punëmarrësve dhe të forcojë pushtetin e punëdhënësve. Për këtë ajo donë të përdorë mjetin e sprovuar – ksenofobinë. Ajo shpreson se me këtë ndjenjë mund të fitojë vota. Me gjithë faktin se migrimi në Zvicër në vazhdimësi ka shënuar rënie dhe se përshtatet me koniunkturën përkatëse ekonomike.

Cili është qëndrimi i Unia?

Sindikata Unia angazhohet për të drejtat e punëmarrësve dhe për trajtim të njëjtë në vendin e punës. Ajo është për një Zvicër të hapur dhe solidarë, në të cilën të gjithë punëmarrësit, pavarësisht nga prejardhja, të kenë të drejta të njëjta.

Ne migrantet/ët, edhe në rastet e shumta ku ne nuk gëzojmë të drejtën e votës, duhet të marrim pjesë në debatin kundër iniciativës shfuqizuese. Andaj ne luftojmë për të arritur shumicën dërrmuese kundër iniciativës së SVP/UDC-së.

Editorial



JO sulmit tejet të rrezikshëm kundrejt të gjithë punëmarrësve

Të dashura kolege, të dashur kolegë

Iniciativa anuluese e SVP/UDC synon të shfuqizojë qarkullimin e lirë të personave. Dhe bashkë me te edhe instrumentet kontrolluese për mbrojtjen e kushteve të punës dhe pagave – të ashtuquajturat masat shoqërore mbrojtëse. Ky është një sulm i pashembullt kundrejt punonjësve në Zvicër. Ti ndoshta shtron pyetjen: A mos nuk është kjo e tepruar? Jo, nuk është e tepruar! SVP/UDC e thotë shumë qartë, se çka asaj nuk i pëlqen përkitazi me qarkullimin e lirë të personave: «Masat shoqërore mbrojtëse qojnë në një treg të punës shumë të rregulluar e të kontrolluar nga shteti: çdo i dyti i punësuar në Zvicër ka vetëm një Kontratë Kolektive të Punës, çdo i treti një pagë të rregulluar minimale dhe çdo i katërti një Kontratë Kolektive të Punës të vlefshëm për gjithë degën industriale.»

KJO është ajo që i pengon iniciuesit. Ata duan të heqin mbrojtjen e pagave dhe të shkurtojë të drejtat e punëmarrësve. Masat shoqërore mbrojtëse forcojnë të drejtat e të gjithë punëmarrësve në Zvicër. Ato përcaktojnë edhe parimin e vlefshmërisë së pagës minimale dhe kushtet minimale të punës si për punëmarrësit vendas ashtu dhe për ata të huaj. Sistemi nuk është i përsosur. Mirëpo në parim është treguar i qëndrueshëm.

Atë që SVP/UDC kritikon dhe donë ta shfuqizojë, është në të vërtetë dhe në veprim e drejta për kushte korrekte të punës për të gjithë punëmarrësit. Nevojat e ekonomisë do të mbulohehin sikur në kohën e punëtorëve me status sezoni me fuqi punëtorë pa të drejta dhe me rritje të punës të parregullt (në të zezë). E gjithë kjo domethënë presion pagash, vende të pasigurta pune dhe më pak të drejta – për punëmarrësit vendosë si dhe ata ardhacakë. Andaj, ne duhet të bëjmë gjithçka, që me 17 maj votuesit ti thonë qartë Jo këtij sulmi tejet të rrezikshëm karshi ne punëmarrësve.

Vania Alleva, kryetare e Unia

News

Iniciativa popullore «Për një jetë më të mirë në pleqëri» – AHV/AVS x13

Pensionet e AHV/AS edhe më tej janë shumë të ulëta, pensionet e trusteeve të pensioneve ulen edhe përkundër kontributeve gjithmonë në rritje. Në të njëjtën kohë rriten e rriten qiratë dhe premitë e sigurimeve shëndetësore. Për shumë njerëz pensionet e pleqërisë nuk mjaftojnë më, për të përthekuar koston jetësore. Prandaj, Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) ka iniciuar nismën popullore «Për një jetë më të mirë në pleqëri» – AHV/AVS x13. Përmes saj do të duhej të përmirësoheshin pensionet e shtyllës së parë. Pasi AHV/AVS është një përkujdesje solidare dhe është për të gjithë, veçanërisht për gratë, burimi më i mirë në pleqëri.

Iniciativa për pensionin e 13-të të AHV/AVS-it mbështetet nga një komitet i gjerë. Bashkërisht ne duam që të forcojmë AHV/AVS-in dhe të kujdesemi për një jetë më të mirë në pleqëri. Mbështet edhe Ti iniciativën dhe grumbullo nënshkrime. Informacione të mëtejme mund të gjelesh në www.AHVx13.ch/www.AVSx13.ch.



Gjyqi federal vërteton të drejtat e graas shtatzënë

Departamenti për industri, tregti e punë (DIHA / SICT) në Sitten me të padrejtë i ka refuzuar një gruajë shtatzënë të drejtën e përfitimit të parave nga arka e papunësisë. Bashkë me Unia gruaja ka bërë ankesë në gjyqin e Kantonit Wallis dhe ka fituar gjyqin. Departamenti në fjalë edhe më pas ka këmbëngul në qëndrimin e vet dhe është ankuar në gjyqin federal. Unia ka përfaqësuar kundërshtimin e ankesës. Sindikata Unia pret që burrat dhe gratë të trajtohen në mënyrë të barabartë, veçanërisht nga ana e autoriteteve – këtë e mbështet vendimi aktual edhe një herë e më shumë.

Shfajësimi: Gjyqi vërteton të drejtën e qasjes për njerëzit e sindikatës

Gjyqi i qarkut në Frauenfeld (TG) vërteton të drejtën e qasjes të sindikalisteve/ëve në vend punishtet e kantieret e punës dhe shfajëson një sekretar të Unia sa i përket thyerjes së rendit shtëpiak (pronësor). Ai ka shfrytëzuar të drejtën e tij dhe ka zbuluar në një kantier pune një rast dumpingu drastik në pagë. Kushtetuta federale garanton të drejtën e qasjes sindikaliste në vendet e punës. Dhe edhe gjykata federale në vitin 2017 ka vërtetur të drejtën e qasjes.

Protestojnë punëtorët e ndërtimeve të «Marty»

Pas shkarkimit pa pritë e pa kujtuar pasoi edhe ikja në falimentim: Rreth 40 punonjës të ndërmarrjes ndërtimore Marty AG protestuan në Arbon (TG) kundër mënyrës së bërjes biznes të shefit të firmës, Patrick Manser. Unia kërkon nga politika, që të rriten pengesat që kanë të bëjnë me kompensimet në rast falimentimi dhe ashpërohet procedura e falimentimit. Pos kësaj, të drejtat dhe përfitimet e punëmarrësve duhet në rast të konkursit të forcohen dukshëm. Nuk është në rregull që punëdhënësit me ndihmën e falimentimit të mund ti ikin përgjegjësisë së tyre.

Migrantët e migrantet kundër iniciativës shfuqizuese

Iniciativa shfuqizuese e SVP/UDC paraqet sulm ndaj të drejtave të punëmarrësve dhe migrantëve/ëve në Zvicër. Përfaqësuesit/et e organizatave të migrantëve luftojnë bashkërisht kundër kësaj politike antisociale dhe raciste.

Hilmi Gashi

Më 22 shkurt në Bernë me ftesë aktivitetëve të sindikatës Unia u takuan veprimtarë e përfaqësues/e të organizatave të migrantëve, për tu mobilizuar kundër iniciativës shfuqizuese të SVP/UDC dhe për një Zvicër të hapur e solidare. Pjesëmarrësit duan që të dëgjohet zëri i migrantëve/ëve dhe që të përfitojnë përkrahjen e shtetasve/ëve të dyfishtë/a dhe njerëzve solidar.

Shumë punëmarrës pa të drejta

Aprovimi i iniciativës do të qonte në humbjen e të drejtave gjithëpërfshirëse për emigrantet/ët e shteteve të BE-së. SVP/UDC nuk donë më pak emigrantë/e në Zvicër, ajo donë to zhveshë ata/o nga të drejtat e tyre, sikur në kohërat e statutit sezonal. Kjo është keq për ne të gjithë. Hulumtimet kanë treguar se sa më të sigurta që janë statuset e qëndrimit aq më të sigurta dhe më të mira janë pagat dhe kushtet e punës. Nevojitet lëvizje e zgjeruar e njerëzve

me mbrojtje të pagave dhe e të drejtave në punë për të gjithë migrantet/ët.

Zëri ynë kundër iniciativës shfuqizuese

Ne duam me vetëdije të kundërshtojmë degradimin e të drejtave tona! Të mos lejojmë që SVP/UDC të na shfrytëzojë në mirantëve/ëve që të realizojë politikën e saj antisociale dhe raciste dhe të përçajë shoqërinë.



Migrantet/ët janë duke u mobilizuar kundër iniciativës shfuqizuese të SVP/UDC-së

TË VOTOSH DOMETHËNË TË BASHKËVENDOSËSH!

Më 17 maj 2020 ne do të votojmë mbi iniciativën e rrezikshme kufizuese. Nisma popullore «Për një migrim të moderuar» e SVP/UDC kërkon shfuqizimin e marrëveshjes për lëvizje të lirë mes Zvicrës dhe BE-së. Ajo venë në pikëpyetje masat shoqëruese (FlaM / Md'a), të cilat mbrojnë pagat dhe kushtet e punës në Zvicër, kështu edhe rrugën bilaterale me BE-në. Andaj ne e emërtojmë atë si iniciativë shfuqizuese. të votojmë mbi iniciativën e rrezikshme kufizuese. Nisma popullore «Për një migrim të moderuar» e SVP/UDC kërkon shfuqizimin e marrëveshjes për lëvizje të lirë mes Zvicrës dhe BE-së. Ajo venë në pikëpyetje masat shoqëruese (FlaM / Md'a), të cilat mbrojnë pagat dhe kushtet e punës në Zvicër, kështu edhe rrugën bilaterale me BE-në. Andaj ne e emërtojmë atë si iniciativë shfuqizuese.

INICIVATIVA SHFUQIZUESE ËSHTË SULM NDAJ TË DREJTAVE TË TË GJITHË PUNËMARRËSVE

LËVIZJA E LIRË = PUNËMARRËSIT MUND TË LËVIZIN DHE QËDNROJNË LIRSHËM

LËVIZJA E LIRË DHE MASAT SHOQËRUESE SHKOJNË DORA DORËS

MASAT SHOQËRUESE KANË FORCUAR DUKSHËM TË DREJTAT E PUNËMARRËSVE NË ZVICËR

Përmes sulmit ndaj lëvizjes së lirë, iniciativa venë në pikëpyetje të drejtat themelore e të gjithë punëmarrësve, veçanërisht mbrojtjen e pagave dhe kushtet e punës. Rifutja e kontingjenteve për fuqi të huaj punëtore, ashtu si donë SVP/UDC, do tua plaçkiste të drejtat një pjesë të mirë të të punësuarve. Presioni dhe konkurrenca ndër punëmarrësit do të rrisë punën e parregullt në të zezë deh dumpingun në paga.

Lëvizja e lirë është një e drejtë me rëndësi për punëmarrësit, pasi ajo u lejon atyre, të lëvizin lirshëm në hapësirën e shteteve anëtare të BE-së, të vendosen e jetojnë dhe të punojnë në ato shtete, pa drojë e diskriminimit.

Është e qartë se lëvizja e lirë dhe masat shoqëruese së bashku ruajnë pagat, pasi kapitalizmi është i prirë, të shfrytëzojnë punëmarrësit nga vendet me nivel të ulët pagash dhe kështu të shkaktojnë dumping pagash.

Masat shoqëruese (FlaM/ Md'a) garantojnë mbrojtjen e pagave në Zvicër përmes zgjerimit të lehtësuar të KKP-ve, futjen e pagave minimale në degët problematike si dhe kontrollin, deponimin e depozitave, detyrimin e lajmërimit për personelin e dërguar nga BE-ja dhe gjatë në rast të shkeljeve të përsëritura. Ky sistem është treguar i qëndrueshëm. Çdo vit zhvillohen me dhjetëra mijëra kontrolle dhe kështu janë regjistruar mes 40% e 20% të shkeljeve. Iniciativa në fjalë donë të shfuqizojë të gjitha këto.

Mes viteve 2003 e 2018 – përkundër trendit ndërkombehtar – numri i të punësuarve që i nënshtrohen KKP-ve me vlefshmëri të përgjithshme është rritur nga 376 000 në 958 600. Ky përparim është arritur falë lehtësimit të vlefshmërisë së përgjithshme të KKP-ve. Politikat e kujdeshme sindikaliste me rastin e zgjerimit të lëvizjes së lirë në shtetet e reja të BE-së ka mundësuar këtë përmirësim dhe ka quar në përmirësimin e vazhdueshëm të të drejtave të punëmarrësve.

E gjithë struktura e pagave do ti nënshtrohej presionit

Si mund të votoj përmes shkresës?
Procedura e saktë ndryshon nga kantoni në kanton. Në parim votimi bëhet si në vijim:

Hapni kuvertën e pranuar të votimit

Tek fleta votuese federale mbi «Für eine massvolle Zuwanderung», oder «Begrenzungsinitiative»/«Pour une immigration modérée (initiative de limitation)» dhe votoni duke shënuar NEIN/NON!

Fletën votuese e vendosni në kuvertën anonime votuese

Nënshkruajeni librezën votuese

Kuvertën votuese e vendosni në kuvertën e pranuar të votimit. Adresa e kthimit (e administratës komunale) duhet të shihet në pasqyrën e kuvertës.

Kuvertën e pranuar të votimit deri me 11 maj 2020 duhet ta dërgoni përmes postës në komunën e vendbanimit tuaj, ose deri me 15 maj ta vendosni në kutinë e shkresave të administratës.

Mendime nga persona me të drejtë vote Shumë arsye kundër iniciativës së SVP/UDC-së

Emine Sariaslan, Marília Mendes

Hüseyin Kürekçi, mekanik

Me 17 maj und do të them qartë JO: SVP/UDC me iniciativën për shfuqizim donë të anulohet lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të sulmojë të drejtat toja. Nëse aprovohet iniciativa në fjalë, Zvicra do të izolohet nga fqinjët e saj. Që kur jam në Zvicër parti-të e djathta gjithmonë kanë iniciuar nisma kundër të huajve e kundër të drejtave të punëtorëve. Në këto rrethana neve na mbetet vetëm një rrugë për ti luftuar ato. Ne, me sindikatën tonë Unia do të luftojmë kundër këtyre sulmeve. Nëse organizohen të gjitha forcat demokratike, iniciativa do të refuzohet nga shumica dhe kështu do të mund të drenonin SVP/UDC-në.



Sudabeh Kassraian, punëtore sociale

Me 17 maj unë do të them një JO të madhe. Ne do të kundërshtojmë. Kontratat Kolektive të Punës duhet të forcohen dhe pagat minimale në Zvicër të mund të realizohen. Të drejtat tona nuk guxojnë të humben. Për këto rregulla kushte të punës është luftuar kohë të gjatë.



Anna Luisa Ferro Mäder, gazetare e pensionuar

Kur unë në vitet e 80'ta erdha në Zvicër ende kishte statuse sezonesh. Për një punëmarrës të huaj ishte e vështirë të fitonte lejen vjetore të qëndrimit dhe të realizonte bashkimin familjar. Unë nuk dua të përjetojë edhe njëherë situata të tilla. Andaj unë me 17 maj do të refuzoi iniciativën shfuqizuese të SVP/UDC-së.



Dominique Binggeli, kontabiliste

Unë me 17 maj do të votoj qartë JO. Aprovimi i iniciativës së SVP/UDC-së do të qonte në anulimin e marrëveshjeve bilaterale me BE-në dhe anulim të lëvizjes së lirë të njerëzve. Gjithashtu të drejtat e punëmarrësve do të shkurtoheshin në mënyrë drastike dhe do të eliminohej mbrojtja e tyre. Dumpingu në paga dhe puna e parregullt në të zezë dio të bëheshin përditshëm. Kjo nuk guxon të ndodh!



Vasco Pedrina, ish bashkë-kryetar i Unia

Një iniciativë popullore, e cila donë të kthejë përsëri statuset diskriminuese (sikur ishte statusi jonjerëzor sezonesh), të shfuqizojë masat për mbrojtjen e pagave si dhe marrëveshjet bilaterale me BE-në, të cilat sigurojnë vendet tona të punës, ne duhet ta luftojmë me të gjithë forcën. Unë votoj qartë me JO!



Ngrohja globale: nevojiten politika të reja klimatike Greva klimatike – ristrukturim ekologjik-shoqëror

Rinia e klimës ka të drejtë: është momenti i fundit! Ngrohja e klimës dhe politika e klimës kanë të bëjnë me të gjithë ne, sepse e ardhmja jonë vihet në lojë. Andaj Unia mbështet Strike for Future (Greva për të Ardhmen) të 15 majit. Njëkohësisht është e qartë: Një ekonomi që nuk shkatërron burimet tona natyrore dhe drejtësia sociale nuk janë në kundërshtim. Këto duhet të për bashkohen në projektin e ristrukturimit ekologjik-shoqëror.

Peppina Beeli

Duke pasur parasysh faktet, vështirë se është e mundur të mbivlerësohen pasojat e ardhshme të ngrohjes globale. Por edhe pse kërcënimet janë i njohur prej dekadash, politika fare nuk ka lëvizur nga vendi. Vetëm vitin e kaluar më në fund ndodhi një lëvizje në këtë çështje: në mbarë botën, të rinjtë thirrën greva dhe demonstrata për klimën. Më 29 shtator, vetëm në Bernë, 100 000 njerëz dolën në rrugë, ndërsa në të gjithë botën ishin disa miliona.

Thirrja Strike for Future (Greva për të Ardhmen)

Falë rinisë së klimës ngrohja globale është ngjitur në krye të agjendës politike gjithandej deh këtë shanse tani duhet shfrytëzuar. Andaj Unia mbështet aksionin e ardhshëm të rinisë së klimës në Zvicër, të Strike for Future (Greva për të Ardhmen) me 15 maj. Këtë 7 dhjetor e ka vendosur njëzëri mbledhja e delegatëve. Strike for Future (Greva për të Ardhmen) është një ditë veprimi e decentralizuar, në përputhje me të cilën Unia ka bërë thirrje për bashkëngjitje aktiviteteve

nëpër regjione, qoftë në ndërmarrje apo në kantiere, qoftë në manifestimet publike. Për këtë në muajt e fundit është përforcuar bashkëpunimi mes Unia dhe grupeve lokale të klimës.

Tani është i nevojshëm ristrukturimi eko-social

Unia, që nga themelimi i saj është shprehur për ndërlidhjen e sfidave ekologjike dhe sociale. Këtë traditë është duke u mbështetur tani kur kërkohet investime në metodat e prodhimit dhe ndërtimit të qëndrueshëm ndaj mjedisit dhe krijimit e vendeve të punës në «ekonominë e gjelbër». Gjithashtu ajo do të luftojë për të siguruar që përfituesit aktualë dhe ata që janë përgjegjës për emergjencën e klimës të marrin përgjegjësinë për kostot e një konvertimi të tillë, për tu mos ngarkuar të ardhurat e vogla dhe të mesme. Pjesëmarrja dhe të drejtat e trajnimit e arsimimit për punonjësit, veçanërisht në lidhje me çështjet mjedisore dhe klimatike, duhet të bëhen çështje të vetëkuptueshme. Bazuar në këto parime, Unia aktualisht është duke përpunuar një program specifik.



Intervista



Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës – BSZ (SGB/ USS) dhe Travail.Suisse kanë nisur një fushatë të përbashkët kundër iniciativës shfuqizuese. Pierre-Yves Maillard, kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës si dhe deputet nacional i PSd sqaron për Horizonte, përse është urgjent lufta kundër iniciativës.

Pierre-Yves Maillard, përse kjo fushatë e përbashkët kundër iniciativës shfuqizuese?

Ne angazhohemi fuqishëm kundër iniciativës shfuqizuese, pasi që ajo venë në pikëpyetje të arriturat sindikaliste. Shfuqizimi i lëvizjes së lirë do të vinte në pikëpyetje masat shoqërore. Këto na lejojnë të rregullojmë me fortë të tregut të punës. Tek to bëjnë pjesë, fjala bie mundësia, që KKP të shpallet më thjeshtë me vlefshmëri të përgjithshme dhe për të miratur kontratën normale të punës. Falë këtyre masave kemi mundur të rrisim dukshëm numrin e punëmarrësve që i nënshtrohen një KKP-je dhe të cilët kanë të drejtë në pagë minimale. Ne duam që të mos i humbim të drejtat e fituara deri më tani dhe të mos kthehemi në një treg pune, në të cilin rritet puna në të zezë, përkeqësohen kushtet e qëndrimit e dobësohen kontrollet si dhe mundësohet shfrytëzimi i egër i punëmarrësve. Pos kësaj lëvizja e lirë e njerëzve ka fuqizuar të drejtat dhe sigurinë e mijëra punëmarrësve të huaj. Iniciativa venë këto në pikëpyetje. Ne kemi luftuar statuset sezonale dhe nuk duam të kemi përsëri statuse të ngjashme.

Qeveritarja federale Keller-Suter ka thënë se votimi mbi iniciativën shfuqizuese është ndoshta më rëndësishmja në këtë legjislaturë. A pajtohesh me këtë?

Po, ky është një votim vendimtar. BE-ja është partner yni i rëndësishëm ekonomik, më shumë se gjysma e eksporteve zvicerane shkojnë atje. Nëse me 17 maj kemi një aprovim, ne do të rrëshqisim në një fazë pasigurie. Kjo nuk do të ishte e mirë as për firmat e as për punëmarrësit. Të djathtët dhe punëdhënësit do të kërkohet programe kursimi dhe liberalizim, që përmes konkurrencës të mënjonin humbjet, të cilat do të krijoheshin me qasjen e vështirësuar në tregun e BE-së. Pas 20 viteve do të kishim një treg pune edhe më të dobësuar e më pak të rregulluar dhe ne do të përballëshim me një ofensivë çrregulluese.

A nuk do të ishte e mundur të negocioheshin marrëdhënie të rregulluara me BE-në pa lëvizjen e lirë të njerëzve?

Teorikisht është gjithçka e mundur. Zvicra ka argumente të mira. Ajo është një partnere e rëndësishme për BE-në. Mirëpo çështja është: Përse të vihet në pikëpyetje lëvizja e lirë e njerëzve dhe të rrezikohen marrëdhëniet me BE-në? Vet SVP/UDC donë që të vijnë njerëzit, të cilët «i nevojiten ekonomisë». Çka do të ishte atëherë ndryshe? Do të çrregullohej tregu i punës dhe migrant/e me më pak të drejta. Këto janë qëllimet e vërteta të SVP/UDC-së.

Pa lëvizjen e lirë të njerëzve Zvicra do të kishte mundësi vet të rregullonte migrimin dhe të kontrollonte imigrimin.

Nëse analizohet zhvillimi i imigrimit, atëherë vërehet se para Marrëveshjes mbi lëvizjen e lirë të njerëzve kishte periudha me imigrim të shtuar. Migrantet/ët nuk vijnë shkallë në lëvizjes së lirë, por shkallë e ekonomisë. Zvicra ka nevojë për punëmarrës jashtë vendit. Problemi është, kur punëdhënësit shfrytëzojnë migrantet/ët për të përkeqësuar kushtet e punës. Mbyllja e kufijve nuk bie asgjë të mirë, ne duhet që tregun e punës ta rregullojmë e kontrollojmë më mirë. Kjo është masë më e mirë. Kjo nuk është diskriminuese dhe favorizon përparimin social.

Ka sindikalistë që mbështesin iniciativën në fjalë. Çka ju thua ti këtyre kolegeve e kolegëve?

Unë ju them atyre, që SVP/UDC dhe shefi i tyre nuk duan më pak imigrim. Ata duan më me dëshirë migrante e migrantë pa të drejta në një treg pune të parregulluar, në të cilin sindikatat nuk do të kishin vend. Andaj është me rëndësi që me 17 maj të votohet me JO.

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Pushimi i lehonisë: A lejohen shkurtimeve e pushimeve vjetore?

Para pak kohësh jam bërë nënë. Krahas pushimit tim të lehonisë, unë qysh 10 javë para lindjes shkaku i komplikimeve në shtatzëni kam munguar nga puna. Tani kam vërejtë se shefi im mi ka shlyer ditët e pushimit vjetor me arsyetimin se këtë vit kam munguar gjithsej 6 muaj, andaj 25 ditët e pushimit tim vjetor mi ka shkurtuar në 15 ditë. A është kjo e shtatzënisë?

David Aebly: Jo. Ligji parasheh që në rast të mungesave afatgjata (Sëmundja, aksidenti, shërbimi ushtarak) guxojnë të shkurohen pushimet vjetore. Mirëpo kjo, vetëm atëherë nëse punëmarrësi ka munguar për dy muaj të tërë. Atëherë pushimet vjetore për një muaj të plotë mungese mund të shkurohen për 1/12-tat. Ndryshe është puna kur mungesa ka të bëjë me shtatzëni: Këtu pushimet vjetore mund të shkurohen, vetëm në rastet kur punëmarrësi ka munguar jo vetëm dy muaj, por së paku 3 muaj të plotë. Shkaku i 14 javëve të pushimit të lehonisë, nuk guxojnë të shkurohen pushimet vjetore. Ju keni munguar gjithsej 24 javë (përafërsisht 5,5 muaj). Sidoqoftë kjo i bie diçka më shumë se 3 muaj në 14 javët e pushimit të lehonisë, për të cilat edhe ashtu nuk guxojnë të bëhen shkurtime. Pjesa tjetër e gati 2,5 muajve edhe pse i bie në kohën e shtatzënisë, që në parim guxojnë të shkurohen, mirëpo tek pas tre muajve.

Work, 14.02.2020

Shkarkimi: Rruga më e shpejtë për deri tek paratë e mëditjet së papunësisë

Unë plotësisht papritur nga firma ime kam marrë shkarkim nga puna për arsye ekonomike. Unë jam i martuar, ndërsa gruaja ime nuk është në marrëdhënie pune, dhe ne kemi 4 fëmijë. Nuk kam pasur mundësi për të kursejë para. Andaj kam nevojë që sa më parë të marrë paratë e mëditjet së papunësisë. Çka mund të më këshilloni?

Markus Widmer: Ne ju sugjerojmë që ju gjatë kohës së afatit të shkarkimit të lajmëroheni tek Qendra Regionale për Ndërmjetësim të Punës (RAV / l'ORP). Për tu lajmëruar ju duhet që të shkoni personalisht tek RAV / l'ORP apo në Kantone të caktuara tek administrata komunale. RAV / l'ORP do tu jap juve formularë të ndryshëm, të cilat ju duhet ti plotësoni vet ju apo ti punëdhënësi juaj. Aty ju mund të zgjidhni vet arkën tuaj të papunësisë. Kjo do të verifikojë se a keni të drejtë përfitimi të parave të mëditjeve në rast papunësie. Për tu shpejtuar kjo, duhet të dorëzoni dokumentacionin e kompletuar. Arkës së papunësisë nga ju i nevojiten:

1. Kërkesa për kompensim të parave të papunësisë e plotësuar tërësisht dhe e nënshkruar nga ju.
2. Formulari i dyfishtë i lajmërimit zyrtar.
3. Vërtetimi i punëdhënësit për tri vitet e fundit, i nënshkruar nga punëdhënësi gjegjës (një formular për punëdhënësin), një kopje e kontratës së punës tek punëdhënësi i fundit, kopjet e të gjitha dëftësive të fletë llogarive të të ardhurave, kopjen e shkarkimit të fundit nga puna.
4. Formulari i plotësuar nga ju mbi «Detyrimi i mbajtjes së fëmijëve».
5. Vërtetimi i lajmërimit në komunën banuese (Vërtetimi i pranimit të shkresave).
6. Kopjen e kartës suaj bankare apo postare.
7. Formulari tërësisht i plotësuar e nënshkruar nga ju mbi «Të dhënat për personin e siguruar». Këtë formular do ta merrni gjithmonë përmes postës rreth datës 25 të çdo muaji. Vini re ju lutem, që pa këtë formularin nuk do të bëhet pagesa.

Work, 14.2.2020



Nuk është në rregull që për këtë krizë punëtorët të paguajnë me shëndetin, pagat apo punën e tyre! Që kjo të mos ndodhë, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar!

Të bashkuar ne jemi më të fortë: A jeni edhe ju anëtarë i Unia?

Tubimi informues i aktivistëve sindikalistë shqiptarë në Cyrih Paqe me Zvicrën, paqe me veten!

Aktivistët shqiptarë të sindikatës së punëtorëve Unia organizuan një ligjëratë për deklarimin e tatimit në Zvicër. Mesazhi: Gjithçka shkon më mbarë në mënyrë të konsultuar dhe të hapur. Rruga legale është gjithmonë më e sigurt.

Nga Kujtim Shabani, Cyrih, 29 shkurt 2020

Detyrë mbi detyra. Detyrë para të gjitha detyrave: Deklarimi i tatimit. Në Zvicër. Aty – pothuaj – fillon dhe mbaron patriotizmi. Aty fillon dhe mbaron mirëqenia e qytetarëve të Zvicrës. Dhe kjo është ndër mirëqeniet më larta në Tokën ku po jetojmë. Prandaj deklarimi i tatimit në Zvicër e ka këtë status që e ka. Prandaj ai është temë diskutimesh në logje të ndryshme. Prandaj...

Në ambientet e konferencave të sindikatës së punëtorëve Unia të Cyrihut dritat qëndrojnë ndezur. Të premtën e 28 shkurtit të këtij viti nga ora 19 deri pas orës 21 të darkës! Një javë më e gjatë! Një fundjavë më e shkurtër...? Një grup shqiptarësh i kësaj sindikate në Zvicër kishte thirrur një takim. Një ligjëratë mbi tatimin! Deklarimin e tatimit. Dhe, deklarimin e tatimit nga këndvështrimi i Marrëveshjes për Mënjanimin e Tatimit të Dyfishtë.

Së kanë për herë të parë. Ata prej vitësh organizojnë takime me tema aktuale dhe të dobishme me anëtarësinë shqiptare të këtij grupi sindikal. Por edhe me komunitetin. Takimet e tyre janë të hapura. 200 000 anëtarë numëron sindikata e punëtorëve Unia në Zvicër. Dhe 20 000 prej tyre e quajnë veten shqiptarë, rrëfen Sheqir Berisha, i cili bashkë me Violeta Ruoss dhe Xhafer Sejdiun i prijnë takimit.

Ata e kanë zgjedhur që rreth 30 të interesuarve për këtë temë t'u flasë ish bashkëpunëtorit i tyre kontabilist, Gzim Dani. Ai i prezanton njëherë llojet e tatimeve që mblidhen në 26 kantonet e Zvicrës. Duke filluar nga ato në të ardhura dhe të pasurisë deri tek ato të pronës dhe

të të dhënave. Mbi 15 lloje të tatimeve mblidhen në Zvicër!

Secili nga këto tatime ka rëndësinë e vet. Ato gjithsesi, për aq sa u përkasin qytetarëve, për një përllogaritje të drejtë dhe të papenalizuar, duhet të deklarohen me përpikëri. Njerëzit s'duhet të gënjejnë nga deklaratat e miqve të tyre për faturën tatimore. «Çdo rast është më vete», shprehet Dani. Kujt i vlon dëshira të krahasohet me tjetrin, ta shpallë dosjen para specialistit.

Ajo për çka qytetarët duhet të jenë të vëmendshëm dhe të përgatitur është momenti kur një anëtar i familjes, për shkak të arrijtes së moshës madhore, mbi 18 vjet, dhe duhet ta deklarojë tatimin veçmas. Ky ndryshim sjell detyrimisht një faturë më të lartë tatimore, e cila, varësisht nga rasti, mund të shkojë në më tepër se njëmijë franga.

Temë qendrore e ligjëratës së Gzim Danit ishte përfshirja e kontove dhe pasurive në vendlindje në deklarimin e tatimit në Zvicër. Ai pledon fort për këtë gjë. Këto realitete të vendlindjes, në fakt është dashur të konsiderohen edhe deri më tani. Por, nga janari i vitit të kaluar, kjo tanimë është bërë e detyrueshme.

Sipas tij, nga njëra anë, kjo për një rast imagjinari, me të ardhura vjetore prej 85 000 frangave në Zvicër, nuk sjell ndonjë barrë vërtet më të përfillshme financiare. Përfshirja e pasurive të vendlindjes në deklarimin e tatimit në Zvicër, gjithmonë varësisht nga rasti, mund të shkojë në ndonjë qind franga zvicerane më tepër.

Nga ana tjetër, deklarimi i këtyre pasurive në formularët e tatimit në Zvicër, i lehtëson gjërat tjera, të cilat e presin një emigrant në Zvicër. Për shembull procedurën për përfitimin e asistencës plotësuese, që në Zvicër gjermane njihet si «Ergänzungsleistungen». Përndryshe, informacioni bankar tani shkëmbehet me automatizëm. Ndërkohë pasuritë kadastrale në vendlindje janë të aksesueshme nga autoritetet zvicerane.

Deklarimi fillestar i pasurive të vendlindjes në Zvicër zyrtarisht bëhet përmes një «vetëpadië». Atëherë autoritetet bëjnë një përllogaritje në mënyrë retrograde për dhjetë vjetet e kaluara, por që, sipas përvojës së deri tanishme, ato e vlerësojnë hapin e «vetëdenoncimit», duke e amnistuar deklaruesin nga barra e një dekade dhe përllogaritja fillon nga 01.01.2019.

Sipas Danit, gjithçka shkon më mbarë kur bëhet në bashkëpunim me specialistin e tatimeve. Njerëzit duhet të jenë të hapur dhe të mos bien pre e paragjytimeve, si ato të gjoja barrave të larta tatimore në rast kapitali në banka. Ata duhet të vënë në dispozicion gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Për atë, rruga legale është më e shkurta dhe më e sigurt. Paqë me Zvicrën, paqë me veten!

Edhe një: Autoritet janë shumë të gatshme t'i dëgjojnë ankesat e deklaruesve të tatimit dhe t'i konsiderojnë arsyetimet e tyre të bazuara.

Debati i pjesëmarrësve në takim ishte i gjallë. Nuk ngeli pyetje pa u sqaruar.

Koronavirusi: Të drejtat e juaja si punëmarrës/e

Të drejtat e punëmarrësve vlejnë edhe gjatë një krize mjekësore, siç është kjo që jemi duke përjetësuar aktualisht. Në vijim disa nga pyetjet dhe përgjigjet më të shpeshta. Listën e plotë si dhe informacione tjera mund ti gjeni në www.unia.ch/coronavirus

1. Çfarë obligimesh ka punëdhënësi im, për të mbrojtur shëndetin e punëmarrësit?

Punëdhënësi duhet të kujdeset për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve të tij si dhe të ndjekë e zbatojë udhëzimet e autoriteteve shëndetësore.

2. Unë në rast se jam i sëmurë, apo kam simptoma dhe më duhet të qëndroj në shtëpi. A do të marrë edhe më tej pagën?

Nëse jeni i sëmurë, duhet të qëndroni në shtëpi. Ju keni të drejtë në përfitim të mëtejshëm të pagës në rast sëmundjeje (Neni 324a OR/CO). Si gjithmonë juve ju nevojitet një vërtetim mjekësor. Ju duhet përmes telefonit të caktoni një termin tek mjeku.

3. Ndërmarrja ime është mbyllur shkaku i Koronavirusit. A do e marrë pagën?

Nëse ndërmarrja juaj ka vendosur krye në veti të mbyllur dyert e saj, atëherë punëdhënësi është i detyruar tua paguajë më tej pagën. Nëse një ndërmarrje duhet të mbyllet shkaku i një vendimi zyrtar, ekziston e drejta punëmarrësit për vazhdimin e marrjes së pagës. Pasi punëdhënësi bartë rrezikun ekonomik

të ndërmarrjes. Punëdhënësi mund të kërkojë kompensim në punë me kohë të shkurtër nga fondi i papunësisë sipas zgjedhjes së tij.

4. Shkolla/parashkollorja është mbyllur dhe mua më duhet të qëndroj në shtëpi shkaku i fëmijëve. Si janë të drejtat e mia në punë dhe deh a do të vazhdojë të marrë pagën?

Pasi keni detyrimin e përkujdesjes karshi fëmijëve tuaj, punëdhënësi duhet tua paguajë të ardhurat për aq kohë, sa ju të keni gjetur një zgjidhje për kujdesin e fëmijëve. Unia kërkon nga autoritetet të lejojnë mjetet, që sigurohet pagimi i mëtejshëm i pagës.

5. Unë jam i punësuar me pagë në orë ose me punë të përkohshme dhe detyrat e mia janë anuluar për shkak të virusit. Çfarë të drejtash kam?

Pavarësisht nëse jeni i punësuar me pagë në orë ose në muaj, të drejtat tuaja mbeten të njëjta. Nëse jeni një punonjës i temporal dhe ndërmarrja për të cilën ju punoni ju dërgon në shtëpi për shkak të virusit, zbatohet kontrata e punës. Atëherë, agjencia që ju ka punësuar, duhet t'ua paguajë të ardhurat.